



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 1418/2 Prot.

Tiranë, më 11 . 06 2025

**NJOFTIM PËR KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KRITERET PARAPRAKE
PËR THIRRJEN SHPALLJE NJOFTIMI PËR VEND TË LIRË PUNE NË QENDRËN
E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE KUKËS**

Komisioni për zhvillimin e procesit të konkurimit për 1 (një) vend të lirë pune në Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kukës, ngritur me urdhrin nr. 383, datë 09.06.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, u mbledh më datë 11.06.2025, me qëllim shqyrtimin e aplikimeve, sa i përket përmbushjes së kërkesave të posaçme dhe dokumentacionit sipas thirrjes me nr. 1418 prot., datë 02.06.2025.

Rezulton se për këtë vend vakant ka shprehur interes 1(një) aplikant si vijon:

- Z. Mehmet Sefaj

Pas shqyrtimit të dosjes personale nr. 1305/1 prot., datë 04.06.2025, të dorëzuar nga aplikanti, sipas metodologjisë së vlerësimit, Aneks-it 1 të miratuar me urdhërin nr. 53, datë 26.05.2021 *“Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës parësore”*, rezulton se aplikanti Z. Mehmet Sefaj nuk i plotëson kriteret për të vazhduar procesin e konkurimit.

Arsyet e skualifikimit: Referuar kriterëve të posaçme për shpalljen: *“Shpallje njoftimi për vend të lirë pune në Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kukës”* si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, konkretisht librezës së punës, rezulton se kandidati nuk plotëson kriterin e eksperiencës: jo më pak se një vit eksperiencë në punë si jurist/avokat.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
(në mungesë)**

**DREJTORI I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT TË
NDIHMËS PARËSORE**

Patricia Pogaçe



Rruga “Jordan Misja”, Tiranë